



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BLLATË

Nr. 762/2 Prot.

Bllatë, më 01/07 2025

Lënda: Kërkesë për njoftim publik

Me 13229
Dokument 03725

DREJTORISË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

**DREJTORISË SË STATISTIKËS, PAGESAVE, ANALIZËS SË TË
ARDHUARVE DHE ADMINISTRIMIT TË BORXHIT**
Sektorit të Monitorimit të Borxhit dhe Bashkëpunimit me Tatimet

**DEPARTAMENTIT EKONOMIK DHE BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E ASETVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

TIRANË

Në zbatim të marrjes së masave për rikuperimin e borxhit doganor, mbështetur në ligjin Nr.102/2014, datë 31.07.2014 « Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë », i ndryshuar, Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 të DPD-së « Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës », kreu IV, pika 3/b, si dhe Ligjin nr.44/2015, datë 30.04.2015 « Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë » neni 162, pika 2, kërkojmë kryerjen e njoftimit publik të vendimit nr.39, datë 14.05.2025 të Degës Doganore Bllatë (Peshkopi), të marrë ndaj shtetasit Perikli Çaushaj me ID : H10512065E, duke e publikuar në rubrikën « Njoftime » të faqes “web” të Institucionit.

Bashkëlidhur keni kopje të vendimit nr.39, datë 14.05.2025, të Degës Doganore Bllatë dhe shkresën “Njoftim Vendimi”.


Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARI

Bajram KALIA

**Në mungesë dhe me urdhër
Përgjegjësi i Zyrës Operacioneve Doganore**

Shpendi KADRIU



Adresa: Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BLLATË

Nr. 622/4 Prot.

Bllatë, më 24.06 2025

Lënda: Njoftim vendimi borxhi doganor

Shtetasit Perikli Çaushaj me ID: H10512065E

Me adresë: Bashkia Tiranë, Njësia Bashkiake nr.8, Rruga "Qemal Stafa", Pallati nr.582, Apartamenti nr.5.

Në zbatim të ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

Ju njoftojmë se:

Në vijim të konstatimeve të kryera nga Dega Doganore Bllatë, është vërejtur se keni kryer shkelje doganore, kontrabandë, e mbetur në tentativë, në flagrancë.

Për këto arsye:

Dega Doganore Bllatë, bazuar në nenin 268 të Kodit Doganor ka marrë vendimin administrativ Nr. 39, datë 14.05.2025, me të cilin jeni shpallur debitor në shumat e mëposhtme:

- 42,985 detyrime doganore
- 128,955 lekë penalitet

Në total: 171,940(njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet) lekë.

Sa më sipër, luteni që brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit të kryeni pagesat e vendosura në vendim sipas kodeve përkatëse të vendosura në faturën për arkëtim të cilën e keni bashkëlidhur.

Në të kundërt, Administrata Doganore do të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të detyrimeve dhe penaliteteve të vendosura.

Bashkëngjitur keni një kopje të Vendimit nr.39, datë 14.05.2025 të Degës Doganore Bllatë.

K R Y E T A R

Bajram KALIA

Adresa : Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
Dega Doganore Bllatë

Nr. 622/1 Prot.

Bllatë, më 14. 05. 2025

VENDIM Nr. 39

Më datë 14.05.2025, unë, kryetari i Degës Doganore Bllatë, pasi shqyrtova procesverbalin nr.622/1 prot., datë 14.05.2025, të mbajtur nga: Nazmi Tushaj dhe Artan Hysa Hetues në Drejtorinë e Hetimit në DPD, Edvin Myrte dhe Andon Lilo doganierë në Degën Doganore Bllatë, aktbllokimin nr.622 prot., datë 14.05.2025, së bashku me dokumentacionin shoqërues, ndaj shtetasit Perikli Çaushaj me ID: H10512065E,

KONSTATOVA SE :

Më datë 13.05.2025 ora 21:00 në zonën doganore të Degës Doganore Bllatë është paraqitur në hyrje nga Maqedonia e Veriut për në territorin e Republikës së Shqipërisë shtetasi Perikli Çaushaj me mjetin me targë AB498HV. Meqë personi nuk ka deklaruar nëse ka mallra në mjetin e drejtuar prej tij, punonjësi doganor dhe i policisë kufitare pasi kanë vërejtur disa bidona në mënyrë vizuale në mjet duke dyshuar se mund të kishte mall të padeklaruar në të, e kanë kaluar atë për kontroll në vijë të dytë. Nga kontrolli i ushtruar në vijë të dytë, është konstatuar se në bagazhin e mjetit dhe në sendilen e pasme të tij, ishin 14 bidona plastikë me gjyrë të kuqe me shënimin 20L të mbushur me karburant, ku për nga aroma ngjasonin me llojin benzinë. Në bagazhin e mjetit ndodheshin dhe 3(tre) bidona të tjerë me nga 30 litra me karburant secili, ku nga aroma karburanti ngjasonte me të llojit naftë. Nga pyetja e personit që drejtonte mjetin, shtetasi Perikli Çaushaj dhe nga faturat që ka paraqitur më pas, ky shtetas ka deklaruar se karburantin e ka marrë në Maqedoninë e Veriut dhe konkretisht në bidona ndodheshin 322.6 litra benzinë dhe 90 litra naftë. Sasia e karburantit së bashku me mjetin janë bllokuar në ambientet e Degës Doganore Bllatë.

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar neni 266 pika 2 dhe 267 pika 2; ligjit 61/2012 "Për akcizat në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 86; VKM nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 443, veprimet e kryera nga shtetasi Perikli Çaushaj përbëjnë shkelje doganore e klasifikuar si kontrabandë parashikuar nga neni 250 pika 1/b. Nga ana e oficerit të policisë gjyqësore është kryer arrestimi në kushtet e flagrancës i shtetasit Perikli Çaushaj për veprën penale të dyshuar "Kontrabandë me mallra për të cilët paguhet akcizë..." parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal.

Në bazë të procesverbalit të mbajtur rezulton se detyrimet doganore të shmangura për sasinë prej 322.6 litra benzinë dhe 90 litra naftë me kod tarifor 2710, janë në shumën 42,984.7 lekë. Duke e rumbullakosur shuma e detyrimeve që duhen paguar për këtë sasi është 42,985 lekë.

Në përfundim, pasi u shqyrtua i gjithë materiali i dosjes, rezulton se nga ana e shtetasit Perikli Çaushaj është kryer shkelja doganore e klasifikuar si kontrabandë, shklje kjo e mbetur në tentativë dhe bazuar në nenet 250 pika 1/b , 3, 4; neni 268 pika 1 dhe 2 dhe neni 269 pika 2, të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Shtetasi Perikli Çaushaj me ID: H10512065E, të shpallet debitor për shumën prej **42,985 (dyzet e dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë**, shumë kjo e barabartë me detyrimet doganore që duhen paguar për sasinë prej 322.6 litra benzinë dhe 90 litra naftë.
2. Shtetasi Perikli Çaushaj me ID: H10512065E të ndëshkohet me gjobë në shumën **128,955 (njëqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë**, shumë kjo e barabartë me trefishin e detyrimeve doganore së shmangura, bazuar në nenin 268 pika 2 e Kodit Doganor.
3. Shtetasi Perikli Çaushaj me ID: H10512065E t’i sekuestrohen përkohësisht objektet e kontrabandës, konkretisht sasia prej 322.6 litra benzinë, 90 litra naftë dhe mjeti me targë AB498HV, derisa të vendosë gjykata, në bazë të nenit 271 pika 1,2 dhe 4 të Kodit Doganor.
4. Zyra e Financës, Borxhit Doganor dhe e Operacioneve Doganore, të marrë masat për kontabilizimin dhe rikuperimin e borxhit doganor së lindur dhe penaliteteve të vendosura.
5. Kundër këtij vendimi subjekti mund t’i paraqesë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave një kërkesë ankimore të arsyetuar, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit. Ankimi duhet të ketë bashkëlidhur mandatin e pagesës së detyrimeve doganore dhe garancinë për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për shumën e sanksioneve të vendosura, bazuar në nenin 282 pika 1 dhe 2 e Kodit Doganor.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Bajram KALIA

